	<b>KËRKESË PËR OFERTË</b>		<b>F-079</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 of 3

## PRISHTINË, KOSOVË

07.03.2025

Nga: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)  
 Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”  
 Rr. Qëndresa, Nr.48, Matiçan.  
 10000, Prishtina, Kosova

### Kontakti:

Tel: +381 38 244 258/ 127

Email: [procurement@kec-ks.org](mailto:procurement@kec-ks.org)

## Kërkesë për ofertë (KPO)

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) e shpall këtë Kërkesë për Ofertë për furnizim me produkte ushqimore për nevojat e KEC dhe shkollës Mileniumi 3-të.

Përshkrimi
Furnizim me produkte ushqimore për KEC dhe shkollën Mileniumi i Tretë

**Si rezultat i këtij tenderi mund të përzgjidhen një ose më shumë kompani.**

**Specifikacionin e kërkesës kërko ne email: [procurement@kec-ks.org](mailto:procurement@kec-ks.org)**

### Dokumentet e nevojshme për ofertim:

- Ofertat duhet të përfshijnë çmimet ME TVSH duke përfshirë transportin;
- Oferta duhet të përfshijë çmimet për njësi në Euro;
- Ofertat duhet të jenë valide së paku 90 ditë, pas datës së dërgimit;
- Furnitori duhet të dorëzoj së bashku me ofertën, **certifikatat e regjistrimit të biznesit;**
- Ofertat duhet të dorëzohen në formatin e kërkesës per ofertë apo në ndonjë format tjetër zyrtar të furnizuesit.
- Oferta origjinale duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur
- Produktet të jenë të nështruara kontrollit nga organi kompetent

	<b>KËRKESË PËR OFERTË</b>		<b>F-079</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 of 3

### **Të dhëna të përgjithshme:**


- Ofertuesit do të njoftohen me shkrim për çdo ndryshim në specifikimet e përmbajtura në këtë KPO;
- KEC rezervon të drejtën të refuzojë çdo dhe të gjitha ofertat e pranuar dhe të kërkojë sqarime për çdo informacion nga secili Ofertues;
- Para përzgjedhjes përfundimtare, mund të kërkohej nga ofertuesit të ofrojnë informacione shtesë të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për të vlerësuar më tej ofertat;
- Ofertat do të vlerësohen nga Komisioni i Prokurimit i KEC në momentin e mbylljes së procesit;
- Vendimi përfundimtar, si rezultat i së cilës do të jetë kontrata, nuk do të bëhet përderisa nuk përfundojnë të gjitha procedurat e brendshme të KEC-it;
- Kontrata do të bëhet duke iu referuar kërkesave të ofertës
- Njoftimi do të bëhet një javë pas marrjes së vendimit nga Komisioni Vlerësues i Prokurimit i KEC;
- KEC nuk merr përgjegjësinë të kompensojë asnjë shpenzim që mund të bëhet nga kompanitë gjatë përgatitjes së ofertave.
- Sasitë e cekura tek kërkesa për ofertë, e paraqet sasinë mesatare vjetore. Furnizimet për këto mallra bëhet sipas nevojave të KEC, në baza ditore, javore, mujore.
- KEC do të bëjë transfer bankar në xhirollogarinë e specifikuar nga furnizuesi pas dorëzimit të secilit artikull të porositur sipas nevojave të KEC dhe pranimi të faturës. Pagesa në kesh nuk do të bëhen.

### **Kriteret e vlerësimit**

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) e mbështet vendimin e vet në ofertën që i posedon përparësitë më të larta ekonomike siç mund të jetë cilësia e shërbimit, por kriteri kryesor i vlerësimit është çmimi më i lirë.

### **Me rëndësi:**

Lëshimi i kësaj kërkesë nuk nënkupton vendim për zgjidhje përfundimtare nga ana e KEC si dhe KEC nuk e ka për obligim pagesën e shpenzimeve të cilat janë rezultat i përgatitjes apo dorëzimit të një oferte.

	<b>KËRKESË PËR OFERTË</b>		<b>F-079</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 3 of 3

### **Afati i Kontratës**

Kontrata do të jetë valide për 1 (një) vit: Prill 2025 – Prill 2026, me mundësi vazhdimi edhe 2 vite të tjera nëse dëshmohet performancë e mirë.

### **Dorëzimi i ofertave:**

Për kompanitë e interesuara, gjitha pyetjet tjera sqaruese mund të bëhen përmes postës elektronike në adresën: [procurement@kec-ks.org](mailto:procurement@kec-ks.org)

*Ofertat duhet të dorëzohen në zarf deri më datë **20 Mars 2025**, në ora **15:00** në adresën:*

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)  
 Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë” ,  
 Rr. “Qëndresa”, Nr.48, Matiçan, 10000, Prishtinë, Kosovë